



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2024-03

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 24 korrik 2024

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e
Njoftimit për Apel**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Kimbërli P. Uest

Mbrojtësit të Pjetër Shalës:
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtjes së Viktimave:
Sajmon Loz

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹, duke vepruar në pajtim me nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e dorëzuar nga z. Pjetër Shala (“Shala” ose “i akuzuari”).² Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) u përgjigj më 23 korrik 2024.³

1. I akuzuari kërkon zgjatje me 30 ditë të afatit për dorëzimin e njoftimit për apel kundër Aktgjykimit të shqiptuar në çështjen KSC-BC-2020-04 pas komunikimit të përkthimit shqip të Aktgjykimit Mbrojtjes, ose, si alternativë, deri më 30 shtator 2024.⁴ Shala parashtron se zgjatja e kërkuar e afatit nuk ndikon në mënyrë të paarsyeshme në kohëzgjatjen dhe shpejtësinë e përgjithshme të procesit.⁵ Sipas tij, kërkesa për këtë ndryshim është e përligjur për shkak se ai ka të drejtë ta marrë Aktgjykimin në një gjuhë që e kupton dhe në kohë të mjaftueshme para afatit për dorëzimin e njoftimit për apel, që është thelbësore për ushtrimin efikas të të drejtave të tij.⁶ Më konkretisht, Shala argumenton se njohja e tij e kufizuar e gjuhës angleze nuk e lejon të shqyrtojë Aktgjykimin dhe t’i japë udhëzime të mirinformuara mbrojtësve.⁷ Ai gjithashtu

¹ F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 22 korrik 2024.

² F00001, Kërkesë për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel të Mbrojtjes, 19 korrik 2024 (“Mocioni”).

³ F00003, Përgjigja e Prokurorisë ndaj Kërkesës për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel të Mbrojtjes, 23 korrik 2024 (“Përgjigja”).

⁴ Mocioni, para. 1, 12, 15. Shih gjithashtu Mocionin, para. 8-10. Shih KSC-BC-2020-04, F00847, Aktgjykim dhe Dënim, 16 korrik 2024 (konfidencial) (“Aktgjykimi”). Shala pohon se Zyra Administrative e informoi Mbrojtjen se parashikonte që përkthimi shqip i Aktgjykimit do të ketë përfunduar deri në tetor 2024 dhe se një përkthim paraprak do t’i vihet në dispozicion në fillim të shtatorit 2024. Shih Mocionin, para. 11.

⁵ Mocioni, para. 11.

⁶ Mocioni, para. 4, 6-8. Shih gjithashtu Mocionin, para. 11. Shala shton se pas shpalljes së Aktgjykimit, ai refuzoi në dy raste të pranonte versionin anglisht të Aktgjykimit dhe nguli këmbë që ta merrte aktgjykimin në një gjuhë që e kupton, konkretisht në gjuhën shqipe. Shih Mocionin, poshtëshënimi 8, që i referohet çështjes KSC-BC-2020-04, F00849, Njoftim në lidhje me Njoftimin e Aktgjykimit, 17 korrik 2024 (konfidencial) (“Njoftimi i Zyrës Administrative”), para. 2, 3.

⁷ Mocioni, para. 6-8.

pretendon se, duke qenë se në apel “do të ngrejë disa aspekte komplekse”, duhet t’i lejohet kohë e mjaftueshme për të shqyrtuar dokumentin voluminoz të Aktgjykimit, në mënyrë që mbrojtësit të mund të përgatisin një njoftim të mirëfilltë për apel.⁸ Në qoftë se kjo kërkesë refuzohet, Shala pretendon se Mbrojtja do të jetë e detyruar ta “sigurojë nga jashtë” përkthimin e versionit të redaktuar publik të Aktgjykimit, dhe të kërkojë, në këtë rast, zgjatjen me 45 ditë të afatit për dorëzimin e njoftimit për apel.⁹ Së fundi, Shala i kërkon Panelit të Apelit t’i caktojë Zyrës Administrative afat për komunikimin e versionit shqip të Aktgjykimit palëve.¹⁰

2. ZPS-ja përgjigjet se Shala nuk arrin të demonstrojë arsye të vlefshme që përligjin zgjatjen e kërkuar të afatit, dhe argumenton se (i) ai nuk arrin të demonstrojë se gjatësia apo objekti i Aktgjykimit përligjin ndryshimin e afatit; (ii) drejtësia e procesit në këtë fazë nuk ndikohet negativisht nga mosvënia në dispozicion e përkthimit shqip, pasi njoftimi për apel është së pari kompetencë e Mbrojtjes; dhe (iii) zgjatja e kërkuar është e tepruar dhe do të shkaktojë vonesë të papërligjur në proces.¹¹ ZPS-ja shton se nuk është kundër një zgjatjeje modeste të afatit, jo më shumë se 30 ditë nga data kur do të ishte normalisht afati për dorëzimin e njoftimit për apel, duke pasur parasysh se Aktgjykimi u shqiptua afër fillimit të pushimit të Gjykatës dhe se i gjithë pushimi bie brenda periudhës 30-ditore për njoftimin për apel.¹²

3. Paneli vë në dukje se, sipas rregullës 176(2) të Rregullores, pala që kërkon të apelojë vendimin e dënimit, dorëzon njoftimin për apel ku parashtrohet arsyet e apelit brenda 30 ditëve nga aktgjykimi i dënimit me shkrim.¹³ Paneli mundet që, *proprio motu* ose kur tregohen arsye të vlefshme, të zgjasë ose të shkurtojë afatin e përcaktuar në

⁸ Mocioni, para. 5.

⁹ Mocioni, para. 9-10. Shala u referohet informacioneve të marra paraprakisht nga kontaktet me përkthyes të pavarur. Shih Mocionin, para. 10; F00001/A01, Shtojca 1 e Kërkesës për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel të Mbrojtjes, 19 korrik 2024 (konfidencial).

¹⁰ Mocioni, para. 13.

¹¹ Përgjigjja, para. 1, 3-5, 7-8.

¹² Përgjigjja, para. 1, 6-8.

¹³ Në këtë rast, Trupi Gjykses e përfshiu dënimin në Aktgjykim. Shih Aktgjykimin, para. 1124.

Rregullore ose të vendosur nga Paneli.¹⁴ Në rastin në fjalë, Aktgjykimi u shqiptua më 16 korrik 2024 dhe versioni i tij konfidencial i shkruar në anglisht iu vu palëve në dispozicion po atë ditë. Duke qenë se gjuha e punës së këtij procesi është anglishtja, afati për dorëzimin e njoftimit për apel fillon ditën e parë të punës pas lëshimit të aktgjykimit në anglisht.¹⁵ Prandaj, çdo njoftim për apel në këtë rast duhet të dorëzohet më 15 gusht 2024.¹⁶

4. Sa u përket argumenteve të Shalës në lidhje me të drejtën e marrjes së Aktgjykimit në shqip para dorëzimit të njoftimit për apel, Paneli rikujton se, sipas jurisprudencës konsistente, përcaktimi dhe formulimi i arsyeve të mundshme për apel janë së pari kompetencë e mbrojtësit.¹⁷ Në këto rrethana, Paneli është i mendimit se mbrojtësit janë tashmë në gjendje ta diskutojnë përmbajtjen e Aktgjykimit me të akuzuarin dhe ta këshillojnë lidhur me arsyet e mundshme për apel.¹⁸ Paneli rikujton se në çështjet gjyqësore në gjykata penale ndërkombëtare ku aktgjykimet janë dhënë në një gjuhë që i akuzuari nuk e kuptonte, zgjatja e afatit për dorëzimin e njoftimit për apel nuk ishte përgjithësisht e përligjur kur mbrojtësi i personit të dënuar mund të punonte në gjuhën në të cilën ishte lëshuar aktgjykimi.¹⁹

5. Për më tepër, Paneli rikujton se, sipas rregullës 176(3) të Rregullores, ai mundet që, në qoftë se i parashtrohen arsye të vlefshme, të autorizojë ndryshimin e arsyeve për apel. Rrjedhimisht, palët kanë mundësinë që, nëse dëshirojnë, të kërkojnë

¹⁴ Rregulla 9(5)(a) e Rregullores.

¹⁵ KSC-CA-2023-02, F00004, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 9 janar 2023 ("Vendimi për Zgjatjen e Afatit në Çështjen *Mustafa*"), para. 2; KSC-CA-2022-01, F00005, Vendim mbi Kërkesën e Haradinajt për Qartësim të Afateve të Apelit, 25 maj 2022 ("Vendimi mbi Afatet e Apelit në Çështjen *Haradinaj*"), para. 3. Shih KSC-BC-2020-04, F00025, Vendim për Gjuhën e Punës, 21 prill 2021; KSC-BC-2020-04, F00289, Vendim për Caktimin e Datave të Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët, 30 shtator 2022, para. 7. Shih gjithashtu F00004, Vendim për Gjuhën e Punës, 24 korrik 2024.

¹⁶ Shih rregullën 9(2) dhe (3) të Rregullores.

¹⁷ Shih Vendimin mbi Afatet e Apelit në Çështjen *Haradinaj*, para. 4 dhe jurisprudencën e cituar në të. Shih gjithashtu Vendimin mbi Zgjatjen e Afatit në Çështjen *Mustafa*, para. 3.

¹⁸ Shih Vendimin mbi Afatet e Apelit në Çështjen *Haradinaj*, para. 4.

¹⁹ Shih Vendimin mbi Afatet e Apelit në Çështjen *Haradinaj*, para. 4 dhe jurisprudencën e cituar në të.

ndryshim të arsyeve për apel pasi të kenë lexuar përkthimin në shqip të Aktgjykimit, me kusht që të japin arsye të vlefshme sipas kësaj rregulle.²⁰

6. Bazuar në sa më lart, dhe megjithëse Paneli e pranon rëndësinë e të drejtës së të akuzuarit për ta marrë Aktgjykimin në një gjuhë që e kupton,²¹ Paneli vlerëson se drejtësia e procesit në këtë fazë nuk do të ndikohet negativisht nga mungesa e përkthimit në shqip të Aktgjykimit.²²

7. Sa i përket kërkesës së Shalës që Paneli i Apelit t'i caktojë afat Zyrës Administrative për t'u komunikuar palëve versionin shqip të Aktgjykimit, Paneli në dukje angazhimin e Zyrës Administrative për t'ia përcjellë Shalës kopjen e përkthimit përfundimtar në shqip "sapo të jetë gati".²³ Për këtë arsye, Paneli i Apelit nuk e gjykon të nevojshme t'i caktojë afat Zyrës Administrative në këtë fazë të hershme të procesit të apelit. Megjithatë, Paneli udhëzon Zyrën Administrative t'i raportojë Panelit të Apelit lidhur me përkthimin në shqip të Aktgjykimit brenda 10 ditësh nga lëshimi i këtij Vendimi dhe t'i bëjë të ditur datën se kur pritet të jetë gati versioni paraprak i parishikuar nga redaktorët dhe versioni përfundimtar zyrtar i përkthimit të Aktgjykimit. Gjithashtu, Paneli thekson se çdo zhvillim në lidhje me këtë çështje do të diskutohet më tej në konferencën para apelit.²⁴

8. Sa u përket argumenteve të Mbrojtjes lidhur me gjatësinë dhe kompleksitetin e pretenduar të Aktgjykimit, Paneli vëren se Trupi Gjykses e dënoi të akuzuarin për tri akuza në lidhje me një qendër paraburgimi, bazuar në konstatimet e tij se ngjarjet kishin ndodhur gjatë periudhës maj-qershor 1999.²⁵ Paneli nuk bindet nga argumentet

²⁰ Shih Vendimin mbi Afatet e Apelit në Çështjen *Haradinaj*, para. 5; Vendimin mbi Zgjatjen e Afatit në Çështjen *Mustafa*, para. 3.

²¹ Shih Mocionin, para. 6.

²² Shih Vendimin mbi Afatet e Apelit në Çështjen *Haradinaj*, para. 6. Shih gjithashtu Vendimin mbi Zgjatjen e Afatit në Çështjen *Mustafa*, para. 3.

²³ Shih Njoftimin e Zyrës Administrative, para. 4.

²⁴ Rregulla 178 e Rregullores përcakton që brenda 21 ditësh nga marrja e njoftimit për apel, kryegjykatësi i panelit thërret konferencën para apelit.

²⁵ Aktgjykimi, para. 1124.

e shkurtra që paraqet i akuzuari në lidhje me këtë se Aktgjykimi është i gjatë apo i komplikuar, në një mënyrë që do të përlligjte zgjatjen e afatit.

9. Thënë kjo, Paneli vë në dukje, *proprio motu*, se pjesa më e madhe e afatit 30-ditor për dorëzimin e njoftimeve për apel bie në pushimin veror të Gjykatës.²⁶ Megjithëse pushimi i Gjykatës në vetvete nuk përbën arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit, numri i kufizuar i personelit në dispozicion mund të jetë faktor në miratimin e zgjatjes së afatit.²⁷

10. Në këtë kontekst, Paneli është i mendimit se ekzistojnë arsye të vlefshme për një ndryshim të kufizuar të afatit për njoftimin për apel. Paneli vëren se Shala kërkon zgjatjen me 30 ditë të afatit pas marrjes së përkthimit në shqip të Aktgjykimit, ose, si alternativë, zgjatjen e tij me 45 ditë. Paneli vë në dukje se zgjatja e kërkuar e afatit, e cila në rastin e dytë pothuajse do ta trefishonte afatin e përcaktuar në Rregullore,²⁸ është, në këtë rast, joproporcionale. Për mendimin e Panelit, zgjatja e afatit për dorëzimin e njoftimit për apel deri më 2 shtator 2024 është e mjaftueshme për të kompensuar për mungesën e kapaciteteve gjatë pushimit veror të Gjykatës.

11. Paneli gjithashtu konstaton se është në interes të drejtësisë që e njëjta zgjatje afati t'i jepet edhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), nëse dëshiron të dorëzojë njoftim për apel, duke pasur parasysh se kjo nuk do të ndikojë në shpejtësinë e përgjithshme të kryerjes së procesit në mënyrë të paarsyeshme në këtë çështje gjyqësore dhe se është në interes të administrimit të efektshëm të çështjeve gjyqësore që kalendari i parashtrimeve në apel të jetë i bashkërenduar.

²⁶ Shih Përgjigjen, para. 6.

²⁷ Vendimi mbi Zgjatjen e Afatit në Çështjen *Mustafa*, para. 6 dhe jurisprudenca e cituar në të. Shih gjithashtu p.sh. KSC-BC-2020-06, IA030/F00003, Vendim mbi Kërkesën e Selimit dhe Krasniqit për Ndryshimin e Afatit, 22 dhjetor 2023, para. 3.

²⁸ Paneli vë në dukje pohimin e Shalës se Zyra Administrative e kishte informuar Mbrojtjen se parashikonte që përkthimi në shqip i Aktgjykimit të përfundonte deri në tetor 2024. Rrjedhimisht, zgjatja e afatit e kërkuar prej tij me 30 ditë pas marrjes së përkthimit në shqip do të çonte në një afat edhe më të gjatë sesa përcakton Rregullorja. Shih Mocionin, para. 11.

12. Së fundi, Paneli vë në dukje se duke pasur parasysh zgjatjen e afatit të dhënë në këtë vendim, dosjet e apelit duhet që, normalisht, të dorëzohen më 1 nëntor 2024.

13. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON Mocionin pjesërisht; dhe

AUTORIZON Mbrojtjen dhe ZPS-në t'i dorëzojnë njoftimet për apel, nëse do të kenë, deri më 2 shtator 2024;

UDHËZON Zyrën Administrative t'i raportojë Panelit të Apelit mbi ecurinë e përkthimit të Aktgjykimit në shqip dhe mbi datën se kur pritet përkthimi i tij përfundimtar, brenda 10 ditësh nga lëshimi i këtij Vendimi; dhe

HEDH POSHTË pjesën tjetër të Mocionit.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E mërkurë, 24 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.